



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 04.09.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancës dëgjimore me kandidatin për pozicionin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit zotin Petraq Milo, propozuar me dekretin nr. 11229 datë: 17.07.2019.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Evis Kushi, Senida Mesi, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Korab Lita, Sadi Vorpsi, Vullnet Sinaj, Dritan Bici, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Artemis Dralo (Malo), Korab Lita

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Arben Elezi

Të ftuar:

Petraq Milo - Kandidat për pozicionin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit

Bledar Dervishaj - Këshilltar Ligjor i Presidentit

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Sot kemi në rendin e ditës seancën dëgjimore dhe vendimmarrjen e Komisionit të Ekonomisë për kandidatin dhe me kandidatin për pozicionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, zotin Petraq Milo, propozuar me dekretin nr. 11229, datë 17. 7. 2019.

Relatore është zonja Evis Kushi. I ftuar është kandidati, zoti Petraq Milo. Mirë se erdhe, zoti Petraq! Nga presidenca është i ftuar zoti Bledar Dervishaj, këshilltari ligjor i Presidentit. Mirë se erdhët, zoti Bledar!

Unë mendoj të procedojmë me dëgjuesën me kandidatin e me relatin e zonjës Evis. Më pas mund të ketë pyetje për kandidatin, ndonjë koment. Më pas, sigurisht, komisioni do të tërhiqet për vendimmarrje rehatuese ndaj seancës, në bazë të ligjit.

Faleminderit!

Zoti Petraq, mendoj se dhjetë deri në pesëmbëdhjetë minuta janë të mjaftueshme. Nëse do të kërkonti kohë më shumë se pesëmbëdhjetë minuta, patjetër që e keni në dispozicion.

Faleminderit!

Petraq Milo – Faleminderit, zoti kryetar!

Arben Ahmetaj – Afrohuni pak, ju lutem!

Petraq Milo – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zonja e zotërinj deputetë, anëtarë të Komisionit të Ekonomisë e të Financave, Më lejoni të vlerësoj angazhimin e komisionit tuaj për të marrë në shqyrtim dekretin e Presidentit në lidhje me propozimin e kandidaturës sime për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Sigurisht, ndjehem i vlerësuar dhe i nderuar nga propozimi i kreut të shtetit, i cili përmes kësaj përzgjedhjeje ka krijuar një bindje kushtetuese dhe besimi institucional në lidhje me cilësitë dhe aftësitë e mia morale e profesionale.

Këto aftësi janë të lidhura me përvojën time në pozicione drejtuese shtetërore sa i takon eksperiencës shqiptare, por po ashtu edhe asaj ndërkombëtare, të cilat përputhen me kriteret dhe përzgjedhjen e kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sigurisht, secili ka një vizion, dhe në vizionin e punës sime do të jenë tetë parime kryesore: pavarësia e institucionit, objektiviteti i tij; integriteti i institucionit; përgjegjshmëria e institucionit për ta kthyer këtë institucion me gjetje e me konkluzione të argumentuara dhe të besuara; profesionalizmi i institucionit; bashkëpunimi institucional me të gjithë partnerët e brendshëm dhe të huaj; interesi publik, që do të thosha se do të jetë i vetmi qëllim i këtij

institucioni, i cili do të përçojë transparencën ndaj përdorimit të fondeve, që është një nga parimet e tjera të punës së këtij institucioni.

Sigurisht, detyrën e kreut të Kontrollit të Lartë të Shtetit e shoh si një përgjegjësi të madhe për të vlerësuar dhe për të arritur të kemi një kontroll sa më personal të përdorimit të fondeve publike. Sot përdorimi i fondeve publike përbën një nga axhendat, një nga elementët kryesorë, qoftë në vendet e rajonit, qoftë në vendet europiane. Sigurisht, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një përgjegjësi në lidhje me përdorimin e këtyre parave, në mënyrë që qytetari dhe individët të jenë të qartë, të informuar se për çfarë përdoren paratë publike.

Të nderuar deputetë,

Sigurisht, reformimi dhe modernizimi i mjaftueshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit është një proces i ndërlikuar, i vazhdueshëm, në kuadrin e gjerë të reformave të ekzekutivit, e po ashtu edhe në kuadër të afritit me Bashkimin European. E tërë Shqipëria është në pritje të çeljes së negociatave. Sigurisht, kjo është një përgjegjësi akoma më e madhe, për shkak se Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të ketë si busull pikërisht ato parime që kanë të bëjnë me përdorimin e parasë publike në vendet europiane, sigurisht në institucionet që kanë një eksperiencë më të gjerë dhe praktika më të mira.

Sigurisht, kjo është në përputhje akoma më shumë në këtë fazë. Kemi një sinergji të strategjisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit me strategjinë e përdorimit të fondeve në vendet më të përparuara europiane. Vizioni sipas të cilit do të punoj, do të jetë ajo që përmenda më parë: institucionet që janë tepër prestigjioze dhe profesionale në këtë fushë, si Organizata Ndërkombëtare e Auditit Suprem, e cila në thelbin e saj rekomandon që në radhë të parë duhet të ketë transparencë në çdo kontroll, në të gjitha elementët, që nga gjetjet, raportimet, rekomandimet apo kallëzimet, në lidhje me të cilat ka bërë këto gjetje.

Të nderuar deputetë,

Unë gjykoj se Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili do të vazhdojë me eksperiencat e tij, ka një përgjegjësi për të përmirësuar në radhë të parë veprimtarinë audituese në dy plane, e njëkohësisht veprimtarinë menaxherial apo më saktë veprimtarinë administruese. Në lidhje me veprimtarinë audituese, do të thosha se ka vend për përmirësimin cilësor të auditimeve të përputhshmërisë, pra përputhje me ligjet e me rregulloret e nxjerra nga ekzekutivi dhe Kuvendi i Shqipërisë, auditime financiare që kërkojnë një stad më cilësor. E fundit fare, që është më e rëndësishmja, në lidhje me të cilën duhet të mendohemi e duhet të punojmë, gjë që sigurisht është edhe në interes të

ekzekutivit, është auditimi i performancës. Thënë me dy fjalë, auditimi i performancës është ajo që bashkon përdorimin e fondeve publike me interesin e qytetarit. Tekefundit, qytetarit nuk i intereson se cili është numri i ndërtesave, cili është numri i kilometrave të rrugëve, cili është numri i spitaleve, por qytetarit i interesojnë rrugë të sigurta, qytetarit i intereson të jetë i shëruar, qytetarit i intereson të ketë dije. Pra, nuk është ana sasiore. Pikërisht ky është thelbi i auditimit të performancës apo i efektivitetit të parasë publike. Ky është një auditim i vështirë, por është një auditim që vendet europiane e kanë kryer, dhe e kanë kryer me sukses. Çfarë bën kjo? Kjo rrit profesionalizmin , por mbi të gjitha rrit përgjegjshmërinë e përdorimit të parasë publike nga ana e institucioneve publike, të cilat drejtohen nga ekzekutivi.

Më lejoni të them se nga ana menaxheriale është e natyrshme që ka vend për përmirësim, ka vend për trajnim të vazhdueshëm, ka vend për mësimin e praktikave të mira, ka vend për çliruar stafin e Kontrollit të lartë të Shtetit dhe të çdo institucioni nga ngarkesat e tepërta, nga presionet e vazhdueshme apo të mundshme, që ndodhin ose që mund të ndodhin.

Më lejoni t'ju falënderoj dhe ta mbyll fjalën time, pa marrë më shumë nga koha juaj! Ju garantoj që, në rast se do të jem në krye të kësaj detyre, të këtij posti, do të tregoj profesionalizëm dhe përgjegjësi në kryerjen e detyrës.

Ju faleminderit për dëgjuesën!

Arben Ahmetaj – Ju faleminderit, zoti Milo!

Besoje se komisioni e ka dokumentacionin që ka shoqëruar dekretin. Ka ndonjë pyetje për zotin Milo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Unë mendoj që në fund të flasë relatorja.

Pyetjet të jenë sa më koncize.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord! patjetër! Sa të negocioni ju me njëri-tjetrin, po e caktoj unë. Ju lutem, zoti Roshi!

Artur Roshi – Duke vlerësuar gjithë prezantimin tuaj, zoti Milo, kam një pyetje: sa jeni interesuar ju për Kontrollin e Lartë të Shtetit, për këtë institucion, se si funksionon në botën e qytetëruar, duke marrë shkas që nga emri i tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Pra, si funksionon ky lloj institucioni, i njëjti institucion, në botën e qytetëruar, pyet zoti Roshi.

Petra Milo – Në Perëndim, po.

Arben Ahmetaj – Do t'ju lutesha ta ngrinit një çikë zërin, që të dëgjojmë, zoti Milo.

Petra Milo – Në rregull!

Artur Roshi – Kjo është. Pra, që nga emri i tij.

Arben Ahmetaj – Sugjeroj që njëherë të bëhen pyetjet, dhe pastaj ju t'u përgjigjeni të gjithave.

Petra Milo – Në rregull!

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, zoti Milo!

Sa i përket personalitetit tuaj dhe kandidimit tuaj për këtë post të lartë, për postin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, besoj se do të ishte nder nëse do ta drejtonit ju Kontrollin e Lartë të Shtetit. Nuk po hy shumë në formimin tuaj, sepse gëzoni gjithë respektin dhe mbështetjen, por mendoj se ju gjendeni në një moment të caktuar, pasi për këtë pozicion, siç dëshmohet edhe nga e shkuara, më shumë janë zgjedhur për ta drejtuar kaubojsët e partive apo të qeverive. Besoj se ju jeni më i urtë nga ç' duhet për këtë detyrë, duke parë edhe historikun e atyre që janë zgjedhur më parë.

Parë nga ky këndvështrim, unë kam një pyetje. Ne kemi punuar të gjithë në administratë, dhe jemi mësuar të shohim drejtues institucioneve e kryetarë bashkish, ministra e të tjerë, të cilët nuk i zinte dera për shkak të personalitetit të tyre ose presionit që ushtronin mbi administratë, po kur vinte Kontrolli i Lartë i Shtetit bëheshin shumë të vegjël, si minj. Në momentin që e kalonin Kontrollin e Lartë të Shtetit bëheshin prapë të mëdhenj. Problemi është se ne kemi parë shumë raporte, të cilat bëhen për institucione të ndryshme...

Arben Ahmetaj – Do t'ju lutesha të dilni te pyetja.

Korab Lita – Do të dal te pyetja, se këto në funksion të saj janë.

I bëjnë specialistët nëpër institucione, vijnë te qendra, dhe relacionet përfundimtare apo vendimet ndryshohen, sepse drejtuesit e institucioneve rrinë rrotull institucionit nga tri a katër ditë, e pastaj vjen raporti përfundimtar. Pyetja konkrete është: sa i fortë, sa i paanshëm dhe i vendosur mendoni se do të jeni, për të zbardhur të gjitha shkeljet e për t'i çuar në vendin e duhur, në prokurori ose në gjykatë, për çdo lloj institucioni e për çdo lloj personaliteti, pasi karriera juaj

e gjatë ju ka mundësuar të punoni me shumë personalitete të kohës e me shumë institucione. Pra, sa do të jeni ju i vendosur që ta zbatoni ligjin me përpikëri?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ka pyetje tjetër?

Zoti Milo.

Petra Milo – Në lidhje me pyetjen e parë, në eksperiencën time personale kam qenë një nga krijuesit e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, që në fakt e ka emrin Auditori i Përgjithshëm dhe jo Kontrolli i Lartë i Shtetit. Praktikisht, është me të gjitha standardet dhe me praktikën më të mirë, që është praktikë europiane, veçanërisht suedeze. Do të gjykoja se emri mund të jetë ndryshe, sigurisht, por thelbi nuk ndryshon, për arsye se të dyja institucionet kanë të njëjtin qëllim: të kontrollojnë përdorimin e parasë publike, përdorimin më të mirë të saj, si dhe të arrijnë të kenë tregues. Unë sapo e përmenda, thashë se nuk janë treguesit sasiore. Treguesit sasiore fshehin përgjegjshmërinë e institucioneve publike, kështu që duhen gjetur tregues që përcaktojnë përgjegjësinë e titullarit apo të drejtuesit të institucionit.

Kjo do të ishte përgjigja ime. Nëse do të kishim tregues në shëndetësi, do të kishim tregues sipas të cilëve del se cila është përqindja e njerëzve që rikthehen në institucione shëndetësore. Këto tregues do të vinin para përgjegjësisë secilin drejtues të institucioneve publike. Po e marr si shembull, se s’dua të paragjykoj askënd.

Sigurisht, është një organizatë supreme e auditorëve të të gjitha vendeve europiane, me të cilën Kontrolli i Lartë i Shtetit është aktiv dhe vepron edhe mbi bazën e saj.

Pra, sot në Shqipëri janë shumë institucione, të cilat realisht janë një hap përpara, të cilat janë në vazhdimësi, si KLSH-ja apo institucione të tjera, të cilat janë realisht në linjë me institucionet europiane. Sigurisht duhet kohë që ky institucion të jetë në një nivel me to.

Për sa i përket pyetjes së dytë do të thosha se asnjëherë njeriu nuk mund të japë deklaratë të tilla si “unë jam i pacenueshëm” apo “jam i pashantazhueshëm”. Gjykoj se të gjitha gjëra tqë janë brenda, mosha karriera, familja, pozicionet që kanë pasur të bëjnë me fondet publike në një sasi të konsiderueshme, që në asnjë moment nuk kanë lejuar të çdojnë në abuzim ose të pranojnë diçka që është jashtë karakterit tim.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Milo!

Në procedurë do të vazhdojmë me relatoren dhe pastaj komisioni do të tërhiqet për vendimmarrje.

Pas relatimit, ju jeni i lirë të lëvizni. Procesi i vendimmarrjes është publik, sepse kamerat do të jenë prezente.

Urdhëroni, zonja Kushi!

Evis Kushi - Faleminderit!

Më lejoni, së pari, të shpreh vlerësimet e mia, jo vetëm personale, por me siguri edhe të kolegëve të komisionit për kandidaturën e zotit Milo për seriozitetin, për integritetin, për profesionalizmin, pasi vetë CV-ja dhe reputacioni i tij flasin vetë, kështu që unë nuk po ndalem gjatë në këto vlerësime, por do të shkoja direkt te shqyrtimi i kriterëve formale dhe ligjore të parashikuara në nenin 20 dhe 21 të ligjit në fuqi “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

Së pari, zoti Milo ka përfunduar studimet në vitin 1988, në Universitetin e Tiranës, në sistemin “Pa shkëputje nga puna”, ku i është dhënë titulli “Ekonomist për industrinë”.

Nga konstatime që ka bërë Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, rezulton se në CV-në e zotit Milo nuk ka informacion për veprimtarinë e tij profesionale të periudhës nga viti 1988 deri në vitin 1991, përfshirë edhe kohën gjatë së cilës ka kryer studimet, meqenëse është deklaruar që studimet janë kryer në sistemin “Pa shkëputje nga puna”.

Pra, është një periudhë e gjatë për të cilën nuk ka informacion se çfarë eksperience profesionale ka zoti Milo.

Së dyti, zoti Milo ka plotësuar një formular deklarimi në përputhje me përcaktimet ligjore, ku deklaroi se nuk ka pengesë ligjore për të kandiduar për funksionin e KLSH-së, si dhe do të shmangë çdo pozitë papajtueshmërie para ushtrimit të funksionit. Por, pika 1 e nenit 21 kërkon që gjatë ushtrimit të funksionit të tij, ai nuk mund të jetë anëtar i Kuvendit, anëtar i KM-së, i zgjedhur në organet e pushtetit vendor apo në organet e ndonjë partie politike apo organizate politike. Në fakt, edhe pse zoti Milo nuk ka deklaruar që të ketë angazhime politike, aktualisht ai rezulton të jetë anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së që nga viti 2018 (më saktësisht nga data 15.12.2018).

Mendojmë se zoti Milo duhet ta kishte deklaruar këtë fakt në dokumentacionin që ka paraqitur për kandidimin e tij.

Gjithashtu, zoti Milo ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit edhe me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës së tij si anëtar i Këshillit

Mbikëqyrës të BSH-së për periudhën 2011– 2018, kur është zgjedhur anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së dhe në vitin 2014, por pas problematikave apo shqetësimeve që ka ngritur Komisioni i Ekonomisë, zoti Milo ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i tij si anëtar i Këshillit Kombëtar të PD-së.

Së treti, sjellim në vëmendjen e komisionit se zoti Milo nuk ka qenë pjesë e listës së kandidatëve të vetofruar për këtë pozicion, të cilët iu përgjigjën thirrjes së Presidenti në tetor të vitit të shkuar, si dhe kandidati e ka shprehur interesin për të kandiduar nëpërmjet një kërkesë të protokolluar me shkresën e datës 17 korrik 2019 dhe po në të njëjtën datë Presidenti e ka miratuar kandidaturën e tij.

Këto janë konstatimet që ka bërë Shërbimi i Monitorimit.

Shumë suksese, zotit Milo!

Arben Ahmetaj – Nuk është në procedurë, por do t’jua jap fjalën patjetër.

Urdhëroni!

Petra Milo – Në vlerësimin e periudhës 88-91, në procedurat e CV-ve asnjëherë nuk ka më shumë se 10 vjet, megjithatë unë e kam bërë për 20 vjet. Në qoftë se doni të dëgjoni se ku kam qenë në këtë periudhë, po ju them se kam qenë drejtor i Drejtorisë Ekonomike të Kombinatit të Autotraktorëve të Shqipërisë.

Po e përsëris se në të gjitha procedurat CV-ja shkon deri në 10 vjet, ndërsa unë e kam paraqitur deri në 20 vjet.

Për pikën 2, thuhet “gjatë ushtrimit”, nuk thuhet “para ushtrimit”. Jeni shumë e saktë kur e thoni citimin e nenit, por këtu ka të bëjë me periudhën kur zgjidhesh, pra “gjatë ushtrimit”, heq dorë nga të gjitha funksionet dhe këtë gjë e kam bërë me deklaratë.

Pika 3, për pjesën e Bankës së Shqipërisë, nuk është e saktë, nuk kam dhënë dorëheqjen, por kam qenë në pozicion të ngrirë dhe kjo nuk ka qenë fare në papajtueshmëri me pozicionin që kam pasur.

Sa për dijeni të komisionit, e ndiej për detyrë dhe ndërgjegje qytetare dhe profesionale të them se në punën time në Bankën e Shqipërisë kam qenë një nga modelet për të qenë bashkëpunues, për të mbështetur çdo lloj qeverie, për arsye se e kam konsideruar BSH-në si institucionin më të lartë dhe më prestigjioz për të mbështetur politikën e qeverive, pavarësisht se cila qeveri ka qenë. Nuk kam pasur asnjë qëndrim politik në punën time në Bankën e Shqipërisë.

Ne këtë duhet të kërkojmë, integritetin e njerëzve, pa u ndikuar te përkatësia apo mendimet e njerëzve, se këto janë të drejta të tyre, por rëndësi ka që mos ta shprehin apo ta materializojnë në punën që kryejnë. Pra, duhet të jemi asnjans.

E fundit, unë jam person publik, kam ambicien time profesionale dhe kam shfaqur interes që në janar të këtij viti si për këtë post, edhe për postin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, si çdo njeri që mund të bëjë kërkesë dhe interesin e vet.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Në procedurë dëgjesa është me kandidatin, megjithatë po ju jap fjalën.

Bledar Dervishaj – Është e vërtetë, procedura kërkon dëgjese me kandidatin dhe jo me institucionin propozues, por nisur nga fakti që shërbimet e Kuvendit kanë bërë tre konstatime, dua të them se këto konstatime nuk janë të arsyetuara dhe as të mbështetura në ligj.

Konstatimi i parë, sa i takon faktit që në CV-në e kandidatis nuk parashikohet veprimtaria e punës së tij për vitet ‘88-’91, nuk prek dhe as cenon kushtin e parashikuar nga neni 20, pika c, ku kërkohet që kandidati të ketë ushtruar profesionin jo më pak se 10 vjet, pasi kandidati është me një profesion dhe me eksperiencë profesionale mbi 20 vjet, kështu që ky fakt nuk qëndron dhe citohet pa ndonjë arsye të mbështetur nga shërbimet e Kuvendit.

Sa i takon deklaratës që është bërë nga kandidati, e cila i kërkohet nga institucioni i Presidentit të Republikës, formulari i deklarimit është shumë i qartë dhe i njëjtë për të dy kandidaturat e tjera që janë depozituar dhe janë rrëzuar më parë.

Nga Kuvendi ajo është bërë tërësisht në përmbajtje të nenit 21, në të cilin citohet se Kryetari i KLSH-së gjatë ushtrimit të funksionit të tij nuk mund të jetë anëtar i Kuvendit, anëtar i Këshillit të Ministrave, i zgjedhur nga organet e pushtetit vendor dhe jep listimin e të gjitha funksioneve me të cilat nuk përputhet. Për arsye të papajtueshmërisë së funksionit lëshohet kjo deklaratë, që në rast se propozohet/zgjidhet nga Kuvendi është një periudhë/diapazon kohe që kandidati fillon detyrën pasi bën betimin në Kuvend, ku zgjidhet çdo situatë papajtueshmërie.

Pra, edhe ky konstatim i shërbimeve të Kuvendit nuk qëndron.

Sa i takon listës së Presidentit të Republikës dhe kandidaturave që kanë vetofruar kërkesën e tyre në muajin tetor të vitit 2018, qoftë Kushtetuta, neni 162, qoftë çdo dispozitë e ligjit 154, nuk dikton procesin se si Presidenti selekton kandidaturat.

Hapja e thirrjes është një mundësi shtesë në funksion të transparencës për të marrë cilësitë më të mira nga kandidatët më të mirë, por kjo nuk kufizon mundësinë e Presidentit për të marrë një kandidat jashtë liste, pasi është atribut ekskluziv kushtetues i tij.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Faleminderit, zoti Milo!

Në bazë të procedurës komisioni do të tërhiqet për vendimmarrjen për kandidaturën në lidhje me propozimin për seancë.

Ju uroj suksese!

Më falni!

Kërkoj qetësi!

Kam nevojë për 3 minuta pushim me grupin e maxhorancës. Pastaj të rifillojmë sërish. Zoti Bushati kërkon 5 minuta.

(Pas pushimit)

Arben Ahmetaj - Procedura do të jetë kjo: përfaqësuesit e grupeve apo deputetë specifikë do të shprehen në mënyrë koncize për kandidaturën nga e djathta, nga e majta apo nga qendra. Pastaj do të kalojmë në votim. Ky është sugjerimi. Jeni dakord që të ecim me këtë lloj procedure? Dakord.

Do të ketë një deklaratë të përbashkët apo secili më vete?

Secili më vete. Dakord.

Ju lutem, shkurt!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni detyrim, sepse në finale do të shpreheni me votë për seancën.

Krenar Ryçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Sot po diskutojmë në lidhje me kandidaturën për kryetar të KLSH-së,. Duke parë kriteret që lidhen me këtë funksion, kushtet që duhet të plotësohen nga një shtetas shqiptar, duke parë edhe performancën, përgatitjen që kishte kandidati i paraqitur nga Presidenti i Republikës, mendoj se kandidati disa kushte që lidhen me kriteret i plotësonte më së miri. Gëzon një integritet të lartë moral dhe profesional. Kishte kualifikime të larta profesionale, mbi 10 vjet

eksperiencë në fushën e financës, një kriter bazë ky, që kërkohet për kandidatin. Mendimi im, duke parë përvojën dhe punën që ka kryer kandidati, jam dakord me përzgjedhjen që ka bërë Presidenti i Republikës që ky person të jetë kryetar i KLSH-së.

U bëj thirrje të gjithë kolegëve deputetë që të votojnë jo nga partishmëria, por nga ana profesionale dhe nga përgatitja që kishte kandidati i paraqitur nga Presidenti i Republikës!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zoti Roshi.

Ju lutem, në mënyrë koncize!

Artur Roshi – Që të jem i singërtë më pëlqeu performanca e zotit Petraq Milo, është një kandidaturë që nuk e gjen dot për ta potencuar në një post të tillë. Vlerësoj përzgjedhjen që ka bërë Presidenti i Republikës duke vlerësuar seriozisht këtë institucion të rëndësishëm të shtetit shqiptar.

Zoti Petraq Milo gjatë historisë së jetës së tij ka treguar integritet, pavarësisht nga përkatësi e ideve të tij politike. Në fakt, vendit tonë të tillë njerëz i duhen. Unë e kam të qartë se qëndrimi juaj do të jetë politik, po ju ftoj që të jetë jashtë emocioneve të politikës, të jetë një qëndrim korrekt në raport me ligjin, sepse të gjitha pretendimet e relatores, i pamë që u rrëzuan me shumë inteligjencë nga ana e kandidatit, zoti Milo. Besoj se nuk ka arsye apo motiv përveç qejfmbetjes me Presidentin e Republikës. Pyetja ime: nëse Presidenti i Republikës do të ishte një tjetër dhe nuk do të kishte këtë moment atakues me maxhorancën Petraq Milo do të ishte kandidati i duhur? Llogaria juaj është: do të largohet Presidenti i Republikës dhe ju do të sillni një kandidaturë tuajën. Unë mendoj se ashtu siç ka qenë kandidatura e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjithmonë e opozitës, ju nuk duhet të rrëmbeni çdo qosh të pushtetit në favorin tuaj pavarësisht kuorumit që keni.

Ju bëj thirrje ta lini këtë post të adresuar për opozitën në tagrin e Presidentit, sepse kam bindjen se Presidenti ka bërë zgjedhjen e duhur me zotin Milo.

Arben Ahmetaj - Kam një koment për qytetarët dhe për ata që po na ndjekin: posti i kryetarit të KLSH-së që nga dita kur është krijuar institucioni nuk i ka përkitur asnjëherë Partisë Socialiste. Ajo që thotë zoti Roshi, në respekt të asaj që thatë edhe kur ka qenë PD-ja në pushtet i ka përkitur përsëri PD-së. Kjo që tha zoti Roshi duhet të sqarohet publikisht, që PS-ja nuk e ka mbajtur asnjëherë atë post.

Në respekt të asaj që ju shprehët, po mbaj edhe qëndrimin tim për të sqaruar qytetarët që në vitin 2003 dhe më pas kur PS-ja i kishte mundësitë për ta pasur si post nuk e mbajti. Nuk është kjo logjika. Nuk po flasim politikisht, por po flasim në themel të ligjit dhe të procedurës. Pjesa tjetër është qëndrimi juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Unë ju respektoj kur flisni! Ta ruajmë këtë gjë, sepse është e shëndetshme edhe për publikun.

Për sa i përket relatimit, ai është në referencë të ligjit, i bërë nga zonja Kushi në referencë të qëndrimit zyrtar që kanë mbajtur shërbimet e Kuvendit për sa i përket kandidaturës dhe nuk janë inovacionet tona. Zoti Milo në respekt të kandidaturës sqaroi në mënyrën e tij. Relatori dhe Kuvendi kanë qëndrimin e tyre. Në qëndrimin dhe kuptimin tim, nuk u rrëzuan pretendimet e Kuvendit dhe në procedurë nuk debatohet se kush ka të drejtë sesi qëndron e vërteta. Ka dokumente zyrtare të depozituara në Kuvend dhe secili mund t'u referohet ose t'i publikojë ato. Po, zonjë, cili është qëndrimi juaj?

Suzana Topi - Faleminderit!

Duke parë profilin profesional të kandidatit për kryetar të KLSH-së, të propozuar nga Presidenti i Republikës mendoj se është i duhuri për vetë rëndësinë që ka ky institucion. Përvoja e tij akademike brenda dhe jashtë vendit, si dhe bashkëpunimi me institucione shumë të rëndësishme financiare botërore dhe europiane mendoj se janë faktorë të rëndësishëm për zgjedhjen e kësaj kandidature. Jam e bindur se profesor doktor Petraq Milo me eksperiencën e tij të gjithanshme në fushën e ekonomisë do të përmirësojë, do të përmbushë me profesionalizëm dhe dinjitet këtë detyrë kaq të rëndësishme dhe kushtetuese. Prandaj ftoj të gjithë anëtarët e komisionit të jemi pro kësaj kandidature.

Arben Ahmetaj - Ka ndonjë qëndrim tjetër?

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi - Përpara se të shpreh qëndrimin e grupit të deputetëve të maxhorancës edhe në përgjigje të kolegëve të opozitës, dua të theksoj se ky komision, kjo maxhorancë e ka vërtetuar që në vendimet e marra për përzgjedhjen e kandidaturave në institucionet e pavarura nuk është bazuar në kriteret politike, më shumë sesa në ato profesionale dhe tek integriteti. Këtë e kemi vërtetuar sidomos te Banka e Shqipërisë ku para disa muajve zgjodhëm kandidaturat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju referohem si njeri shumë serioz në komision. Ju lutem, mos i ndërhyjni zonjës Kushi! Jeni i tillë, por pse e prishni?!

Evis Kushi - Ndoshta ju nuk keni qenë deputet në kohën kur ne kemi marrë vendime të rëndësishme për Bankën e Shqipërisë dhe ndoshta nuk jeni në dijeni, por ju siguroj se ky komision është bazuar më tepër në kriteret e profesionalizmit, të seriozitetit dhe të integritetit.

Arben Ahmetaj – Është qytetar i angazhuar.

Evis Kushi - Unë i shpreha pak më parë, gjatë prezantimit të relacionit vlerësimet tona për kandidaturën e zotit Milo, por pavarësisht atyre, qoftë bazuar në CV-në e tij, por edhe në informacionet e tjera, në analizën që na ka ofruar Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit, zoti Milo nuk mund ta këtë besimin e plotë të deputetëve të Grupit të PS-së. Ne do ta votojmë kundër këtë kandidaturë.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Kalojmë në procedurën e votimit. Për dijeninë tuaj ne votojmë për të kaluar në seancë në bazë të ligjit qëndrimin e Komisionit të Ekonomisë pro apo kundër kandidaturës. Pastaj seanca bën votimin në bazë të vullnetit të saj, por në referencë të vendimmarrjes së komisionit. Vendimmarrja e komisionit në Kuvend në seancë mund të bjerë, nëse zoti Milo do të ketë numrat e shumicës. Ju shpjegova anën procedurale.

Kush është pro kandidaturës së zotit Petraq Milo propozuar me dekretin nr. 11229, datë 17.07.2019 “Për pozicionin e kryetari të KLSH-së”? 4 pro. Kundër?

Me shumicë votash kandidatura e zotit Petraq Milo rrëzohet.

Të përgatitet raporti i komisionit!

Falënderoj mediet!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti